



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

PROJEKTVENDIM

Nr 2744, Datë 27 . 02 . 2026

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK PËR VITIN 2025

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës, Këshillit të Bashkisë Lezhë;

Për të vendosur:

1. Miratimin e Buxhetit Faktik për vitin 2025, sipas relacionit dhe tabelave përkatëse, bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

K R Y E T A R I

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 2744/Prot.

Lezhë, më 27. 02 . 2026

RELACION

**LIDHUR ME PROJEKTVEKNDIMIN E PARAQITUR PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
BUXHETIT FAKTIK PËR VITIN 2025**

Të nderuar këshilltarë,

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; ju paraqesim projektvendimin për realizimin e Buxhetit Faktik për vitin 2025 për shqyrtim dhe miratim nga ana Juaj.

Lidhur me realizimin e Buxhetit Faktik për vitin 2025, relatoj si më poshtë:

- Të ardhurat vendore gjithsej janë realizuar 77.1% ose 326,161.5 mijë lekë më pak se plani, respektivisht sipas burimeve janë: Të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar 60.4% ose 345,322 mijë lekë më pak se plani; Të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar 117.8% ose 14,393 mijë lekë më shumë se plani; Të ardhurat nga tarifat vendore janë realizuar 81.1% ose 57,735.2 mijë lekë më pak se plani; Të ardhurat e tjera janë realizuar 137.8% ose 62,502.7 mijë lekë më shumë se plani. Në raport me të njëjtën periudhë të vitit kaluar të ardhurat janë realizuar 107% ose 71,849.4 mijë lekë më shumë.
- Shpenzimet janë realizuar 66.3% ose 906,915.1 mijë lekë më pak se plani, respektivisht, Shpenzimet korrente janë realizuar 74.4% ose 450,455.6 mijë lekë më pak se plani dhe shpenzimet kapitale (investimet) janë realizuar 50.7% ose 456,259.5 mijë lekë më pak se plani. Në mënyrë të detajuar të dhënat e zbatimit të Buxhetit Faktik, jepen në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2025, bashkëlidhur projektvendimit.

Me respekt,

